



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E SHTIMES
MUNICIPALITY OF SHTIME / OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE / MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM / INFORMATION

OFFICE / KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Procesverbal nga mbledhja e II-të e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), e mbajtur më 5 maj 2025, në ora 10:00, në sallën e vogël të Komunës së Shtimes

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Nënkryetari i Komunës, Faruk Beqa, komandanti i Stacionit Policor në Shtime, Haxhi Behluli, Skender Baftiu (KBI), Bajram Gashi (NJPZSH), Vlora Hyseni (ZI), Reshat Gashi (ZBGJ), Albert Ramadani (KLSP), Shpresim Mahmuti (OJQ), Muhamet Mehmeti (ZKK), Muhadin Halili (EVSb) dhe Venera Ahmeti (ZI).

Nënkryetari i Komunës z. Beqa merr fjalën dhe falënderon të pranishmit që janë prezent në këtë mbledhje dhe prezanton pikat e rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 10.03.2025;**
2. **Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;**
3. **Siguria ushqimore (kontrolli i cilësisë, kushteve dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore);**
4. **Të ndryshme**

Faruk Beqa: Pikat e rendit të ditës për të cilat do të diskutojmë sot janë këto. Por mendoj që duhet t'a bëjmë një ndryshim, sa i takon pikës së tretë të rendit të ditës. Sapo u informova që zyrtari në fjalë që do të raportonte për këtë pikë nuk gjindet në punë, por është në pushim, mendoj që kjo

pikë të kalon për mbledhjen e ardhshme të KKSB-së. Jeni të pajtimit? (anëtarët unanimitisht votuan rendin e ditës).

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 10.03.2025 ;

Faruk Beqa: Vazhdojmë me shqyrtimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar. Nëse keni diçka për të shtuar, mund ta bëni tani. Nëse jo, kalojmë në votim. (Duke qenë se nuk kishte diskutime shtesë, anëtarët unanimitisht votuan për miratimin e procesverbalit. Përveç faktit që pika e tretë u hoq nga rendi i ditës, për shkak se zyrtari që do të raportonte gjendet jashtë shtetit). Faleminderit për bashkëpunimin, tani kalojmë në pikën e dytë të kësaj mbledhjeje.

2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;

Faruk Beqa: Për këtë pikë, falenderoj komandantin e policisë dhe i'a jap fjalën.

Haxhi Behluli: Fillimisht, falënderoj të gjithë pjesëmarrësit dhe theksoj se të gjitha takimet e KKSB-së janë të rregullta dhe shumë të rëndësishme pasi trajtojnë çështjet e sigurisë dhe pika të tjera kyçe.

Sa i përket sigurisë, do të përpiqem të jap një pasqyrë të përgjithshme për situatën në rajonin tonë, duke theksuar disa aspekte që lidhen me mundësitë e veprimit nga ana e KKSB-së dhe institucionet e tjera të përbashkëta.

Statistikat për muajin prill tregojnë një kategorizim të veprave penale: Lëndime dhe djegie trupore ka pasur një rënie krahasuar me prillin e vitit të kaluar, nga 14 raste në 7, pra kemi një përgjysmim të numrit të lëndimeve. Lëndime të rënda nuk ka pasur raste që të kenë rrezikuar shëndetin e personave. Lëndime të lehta kanë shënuar një rritje të lehtë. Dhuna në familje dhe kanosja janë ulur krahasuar me muajin e kaluar, nga 4 raste në 3. Lëndë narkotike nga 0 në 1 rast. Vjedhje të rënda nga 11 në 6 raste. Vepra penale në total nga 29 në 26 raste. Në lidhje me incidentet numri i incidenteve nga 15 në 14. Aksidentet kanë pasur një rritje, nga 11 në 13 raste. Gjithsej vepra penale dhe incidente ka pasur një ulje të numrit të rasteve, nga 43 në 38.

Sa u përket arrestimeve dhe urdhëresave të gjykatës arrestimet nga 8 në 9. Urdhëresat gjyqësore nga 23 në 17.

Bashkëpunimi me institucionet po punojmë me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë për të siguruar ekstradimin e personave që kanë urdhëresa në shtete tjera, si për shembull një individ në Mal të Zi me 8 urdhëresa për grabitje.

Sa i përket sigurisë në shkolla, ajo ka qenë maksimale, pa incidente. Nxënësit e klasave të 7-ta dhe të 8-ta kanë realizuar ligjëratë në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit për sigurinë në trafik, parandalimin e drogave dhe çështjet e komuniteteve. Në kuadër të hetimeve, kemi zbuluar dy grupe kriminale që ishin të përfshira në vjedhjet në shkolla dhe vjedhjet e rënda.

Sa i përket parkingjeve të parregullta, po planifikojmë krijimin e një hapësire të përshtatshme pranë shkollës fillore, ku veturat mund të ndalojnë për 3-5 minuta për të lënë fëmijët. Po ashtu, po shqyrtojmë mundësinë e legalizimit të disa parkingjeve për të shmangur ndalimet ilegale. Patrullat policore po kryejnë detyrën e tyre, por duhet të analizojmë mënyrat për të përmirësuar qarkullimin dhe shmangien e kolonave të mëdha.

Trajtimi i situatave tjera si zjarret, çështjet pronësore, mbrojtja e pyjeve, ambienti, personat me probleme psikike, rastet e dhunës familjare dhe grabitjet po zhvillohen në përputhje me planin tonë të veprimit. Për rastet e dhunës në familje, kemi trajtuar një rast ku personi nuk mund të dërgohet në paraburgim për shkak të gjendjes së tij psikike dhe është rekomanduar trajtimi nga psikiatria.

Sa i përket lejeve të taksive, rreth 20 shoferë që operonin pa leje komunale tani janë pajisur me dokumentacionin e nevojshëm.

Në lidhje me grupet kriminale dhe ekstreme si rasti në Kaçanik, po punojmë me kujdes për trajtimin e individëve me bindje të ndryshme dhe po asistojmë me prezencë policore në zonën përkatëse. Aktualisht kemi angazhuar 10 policë që do të veprojnë aty për tre muaj.

Po ashtu, po bashkëpunojmë me Bashkësinë Islame dhe komunitetin fetar për të ndihmuar në edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për çështjet sociale dhe të sigurisë.

Faruk Beqa: Faleminderit shumë komandant, informacionet që na dhatë janë të rëndësishme dhe ndihmojnë shumë në punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Po ashtu, kemi një rekomandim që kemi hartuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike për stabilizimin e situatës së parkingjeve në shkolla.

Haxhi Behluli: Ende nuk kemi ndërmarrë hapa konkretë për këtë çështje.

Faruk Beqa: Atëherë mbetet për t'u trajtuar më tej. Pas shqyrtimit të temës mbi nevojën për krijimin e parkingjeve dhe shmangien e bllokimit të qarkullimit në qytet, u konkludua se kjo është një çështje e rëndësishme që kërkon angazhim të vazhdueshëm. (Meqenëse diskutimi ishte i gjerë, u dhanë disa sugjerime mbi mënyrat e zgjidhjes).

Nëse ka ndonjë pyetje shtesë, po Muhamet ?

Muhamet Mehmeti: Dëshiroj të kontribuoj në diskutimin mbi shkollat, duke qenë se kam punuar në këtë fushë për sigurinë e fëmijëve. Një prej problematikave kryesore është mungesa e një harku të përshtatshëm për parkimin pranë shkollave, gjë që ndikon në sigurinë e fëmijëve. Veçanërisht në një shkollë të caktuar, ka mungesë të mbrojtseve anësore dhe rruga ka gropa në disa vende. Do të ishte e rëndësishme që kjo çështje të adresohet sa më shpejt, pasi siguria e fëmijëve është prioritet.

Haxhi Behluli: Ideja jonë për përmirësimin e parkimeve ka qenë që, në një zonë të caktuar të shtrohet një pjesë e asfaltit dhe të largohen pengesat ekzistuese, duke krijuar hapësirë të mjaftueshme për kalimin e nxënësve. Policia ka rekomanduar krijimin e një harku për parkimin. Po ashtu, është ngritur shqetësimi për mënyrën e transportit të nxënësve me taksì, ku për një automjet të destinuar për 12 persona, shpesh hipin mbi 20 persona.

Faruk Beqa: Pas këtij takimi, do të takohem me Drejtorin e Shërbimeve Publike për ta trajtuar këtë çështje më tej.

Albert Ramadani: Faleminderit komandantit për çdo detaj të dhënë. Dua të informoj se komuniteti lokal për siguri publike tashmë ka një rol më të fuqishëm në raport me Komunën, Zyrën për Komunitet dhe Bajram Gashin, komandantin e njësisë së zjarrfikësve. Në Shtime, kemi qenë të përfaqësuar me katër anëtarë dhe kemi marrë mbështetje nga komandanti me tre anëtarë të zjarrfikësve profesionalë, të cilët kanë marrë pjesë në akademi dhe janë certifikuar si zjarrfikës me të drejtë ndërhyrjeje në biznese të mëdha. Përveç këtyre tre certifikatave, zjarrfikësit tani kanë lejet e nevojshme për të vepruar si njësi.

Faruk Beqa: Albert, nëse tre zjarrfikësit janë certifikuar, a kanë të drejtë të jenë staf i paguar me kontratë?

Albert Ramadani: Po ata mund të jenë staf i paguar dhe kemi disa hapa të tjerë për të trajtuar, përfshirë edhe udhëzuesin fetar, i cili është një çështje e ndjeshme dhe kërkon trajtim më të thellë. Po ashtu, sa i përket personave me probleme shëndetësore, 23 qytetarë nga Shtime figurojnë në regjistra si raste që kërkojnë trajtim.

Faruk Beqa: Ju faleminderit shumë, konstatoj se mbledhja e Këshillit për Siguri në Bashkësi ka përfunduar, shëndet e mirëupafshim në takimin e radhës.

Mbledhja përfundoi në ora : 11:35

